

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr.Rendor	Data e Kërkesës	Objekti i Kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e Përfundimit të Kërkesës	Tarifa
01	29/02/2024	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetar :</p> <p>1. Regjistrin e ndërmarrjeve që institucioni juaj ka në varësi? Kur janë krijuar dhe cila është organigrama e tyre?</p> <p>2. Bilancet e tyre për 5 vitet e fundit...</p>	01/03/2024	<p>Në vijim të e-mail tuaj ju bëjmë me dije se:</p> <p>Agjencia Kombëtare e Pyjeve është një institucion i krijuar në vitin 2020 dhe ka filluar funksionalitetin e saj në Shtator të vitit 2020, në zbatim të VKM nr. 570 datë 17.07.2019 “Për Krijimin, Organizimi, dhe Funksionim e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve, i ndryshuar”, dhe Urdhrit të Kryeministrit me nr. 24 datë 03.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i shfuqizuar me Urdhrin e Kryeministrit me nr. 192 datë 28.11.2022, “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”. (të cilët do t'i gjeni bashkëlidhur e-mail). Në zbatim të këtij urdhri Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka filluar procedurat e ristrukturimit, e cila përfundoi në Prill të vitit 2023. Momentalisht Agjencia Kombëtare e Pyjeve, operon si strukturë qendror duke qenë se degët e saj rajonale nuk janë krijuar ende.</p>	E plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Në zbatim të VKM dhe Urdhrit lartpërmendur, numri i punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Pyjeve është 30 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ.</p> <p>Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit me nr. 24 datë 03.02.2020 “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i shfuqizuar me Urdhrit të Kryeministrit me nr. 192 datë 28.11.2022, “Për Miratimin e Strukturës dhe Organikës së Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, në fund të vitit:</p> <ul style="list-style-type: none">- 2020 numri i punonjësve plan ka qenë 30 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ, dhe numri i punonjësve fakt ka qenë 22 nëpunës civil dhe një punonjës administrativ ;- 2021 numri i punonjësve plan ka qenë 30 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ, dhe numri i punonjësve fakt ka qenë 25 nëpunës civil dhe një punonjës administrativ;	
--	--	--	--	---	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<ul style="list-style-type: none"> - 2022 numri i punonjësve plan ka qenë 30 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ, dhe numri i punonjësve fakt ka qenë 25 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ; - 2023, pavarësisht shfuqizimit të Urdhrit nr. 24, datë 03.02.2020, me hyrjen në fuqi të Urdhrit nr. 192, datë 28.11.2022, dhe procedurës së ristrukturimit të institucionit, numri i punonjësve plan nuk ka ndryshuar duke e lënë atë 30 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ, dhe numri i punonjësve fakt ka qenë 25 nëpunës civil dhe dy punonjës administrativ. 		
02	11/03/2023	<p>Kërkesë për informacion ardhur nga një gazetar :</p> <p>1.Cili është roli juaj në procesin e planeve të mbarështrimit nga Bashkitë?</p>	10/03/2024	<p>Ju bëjmë me dije se:</p> <p>AKP bazuar ne Neni 15 pika 2/e te ligjit 57/2020 “Për Pyjet” ka përgjegjësi e) Mbikëqyrjen e zbatimit të kërkesave ligjore dhe të dokumenteve planifikuese në pyje, si dhe këshillimin e ndërgjegjësimin e</p>	E Plotë	Nuk ka

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

		<p>2. A jepni ju mendim?</p> <p>3. Kush jua kërkon dhe mbi çfarë baze ligjore ju përgjigjeni?</p>		<p>aktorëve në lidhje me detyrimet për pyjet. Në bazë të kërkesës së ardhur nga MTM dhe përcaktimit të specialistëve nga Dr i Përgjithshëm për dhënie të vlerësimeve teknike-ligjore, AKP jep për cdo rast të përcjellë nga MTM vlerësimin mbi Planet e Mbarështimit që bashkitë dërgojnë në MTM për miratim.</p> <p>Kërkesa vjen nga Drejtoria e Natyrës dhe Pyjeve dhe përgjigja jonë bazohet ne Neni 15 pika 2/e te ligjit 57/2020 “Per Pyjet”, ne pikën 5.4 /ç të VKM-së Nr 570 datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, si dhe Udhezimin e Planeve te Mbarështimit të Pyjeve dhe Kullotave” miratuar nga MTM me shkresën nr. 864 datë 30.01.2019</p> <p>Në përgjigje të pyetjes suaj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A keni konstatuar ju ndryshime të parcelave ne planet e hartuara? <p>Specialistët e AKP për ato plane që kanë marrë në shqyrtim nuk kanë konstatuar ndryshime të parcelave</p>		
--	--	---	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<ul style="list-style-type: none">• Kërkojmë një kopje të Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Kullosor në formatin GIS për bashkitë Korçë dhe Gramsh? <p>AKP nuk disponon shape file të RKFP mbasi Sistemi ALFIS nuk gjeneron shapefile të hartave pyjore. Formati i hartave është uebgis dhe shkarkimi mund të bëhet pjesor për grup ngastrash në PDF. Të dhënat alfanumerike janë në formatin excel. Këto shërbime nuk mund të ofrohen në këtë fazë që ALFIS është i paaksesueshëm përdorimi zyrtar i tij nuk mund të funksionojë pa mbështetjen e mirëmbajtjes nga AKSHI.</p> <p>Në përgjigje të pyetjeve tuaja:</p> <ol style="list-style-type: none">a) A është ngritur Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Kullosor?b) Po sistemi i informacionit në pyje në çfarë periudhe dhe çfarë date?c) Kërkojmë gjithashtu rrjetin Kombëtar të sipërfaqeve provë 200x200 të përhershme.	
--	--	--	--	--	--

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

				<p>Ju bëjmë me dije se:</p> <p>a) Regjistri Kombëtar i Fondit Pyjor dhe Kullosor është i ngritur në ALFIS dhe me nisjen e përdorimit zyrtar të tij do të vijojë puna për përditësim dhe azhornim me Planet e reja të Mbarështimit dhe azhornimet vjetore periodike në bazë të VKM-së 171 datë 18.03.2022.</p> <p>b) ALFIS nuk është i aksesueshëm mbasi është në pritje të proceduarve të përmirësimit dhe mirëmbajtjes nga AKSHI, procedura që nuk varen nga ne.</p> <p>Rrjeti i sipërfaqeve provë është për çdo ekonomi që ka hartuar dhe miratuar Planin e mbarështimit pra nuk egziston nje rrjet kombëtar në të gjithë vendin. Ky rrjet vjen me hartat dhe shapefilet për çdo Plan Mbarështimi të miratuar ndërkohë që me nisjen e funksionimit zyrtar të ALFIS-it do të aplodohen në sistem.</p>		
--	--	--	--	--	--	--